



Prania / Dorezuar Priljezja/Priljezja Received / Delivery	23	10	2020	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetja Encl Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSTICK	2237/2020		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.265/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional-procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokollit 1727/2020 të datës 11.09.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë banimi rr "Komandant Kumanova" Nr.65 Lipjan, kundër organit të punësimit-Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 22.10.2020.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.265/2020 e datës 11.09.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].

A r s y e t i m

Komuna e Lipjanit, me datën 30.06.2020 ka shpallur konkursin me nr.1-111-26431 për pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile I në zyrën e vendit Magure" në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi [REDACTED] i cili ju ka nënshtruar testit me shkrim dhe intervistës me gojë. Me datën 10.08.2020 Komuna e Lipjanit ka shpall njoftimin për kandidatin e suksesshëm. Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 10.08.2020 të Komunës së Lipjanit të cilin e ka pranuar me datën 18.08.2020, me datën 11.09.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1727/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.09.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Lipjanit. Komuna e Lipjanit me datë 30.09.2020 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1727/2020 të datës 11.09.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit i datës 30.06.2020 me nr.1-111-26431; Zgjatja e afatit të konkursit e datës 16.07.2020; Vendimi për themelimin e Komisionit Përzgjedhës të shërbimit Civil i datës 23.07.2020 me nr. 1-111-30757. Vendimi për ndryshimin e një anëtarit të Komisionit Përzgjedhës të shërbimit civil i datës 04.08.2020; Lista e aplikantëve; Lista e kandidatëve të ftuar në testin me shkrim; Kopja e testit me shkrim i datës 29.07.2020; Njoftimi i datës

03.08.2020 për intervistën me gojë: Njoftimi për zgjedhjen e kandidatit i datës 10.08.2020 me nr.1-101-30684, Kërkesa për punësim për Ardian Metaj bashkë me dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim për Sylejmon Reçica bashkë me dokumentet e kërkuara; Vendimi për ndryshimin e një anëtarit të Komisionit Përzgjedhës të shërbimit civil i datës 04.08.2020; Autorizimi i MAP-it i datës 29.06.2020 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 30.09.2020 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit [REDAKTUAR] është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon që Komuna e Lipjanit gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit për pozitën “Zyrtar i Gjendjes Civile 1 në zyrën e vendit Magure” është bërë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se kriteret themelore të konkursit për këtë pozitë kanë qenë:

- **Diplome Universitare-Fakulteti Juridik, Administratë Publike dhe Shkencat shoqërore, pa përvojë pune;**
- **Shkolla e lartë me 2 vite përvojë pune;**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar i Gjendjes Civile 1 në zyrën e vendit Magure” është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi është i paqëndrueshëm sepse e gjithë procedura e rekrutimit për këtë pozitë është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Ankuesi z. [REDAKTUAR] i cili ka aplikuar në pozitën “Zyrtar i Gjendjes Civile 1 në zyrën e vendit Magure” i ka plotësuar kriteret e konkursit është ftuar nga menaxherja e personelit për testin me shkrim i cili është mbajtur me datën 29.07.2020 dhe intervista me gojë që është mbajtur me datën 05.08.2020. Pretendim tjetër ankimor i ankuesit është se njoftimi për kandidatin e përzgjedhur nuk është shpallur në web faqen e Komunës dhe pikët e testit me shkrim kanë qenë të manipuluar. Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit janë të paqëndrueshme sepse e gjithë procedura e rekrutimit për pozitën “Zyrtar i Gjendjes Civile 1 në zyrën e vendit Magure” është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Komisioni Përzgjedhës është formuar në bazë të nenit 7 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, testi me shkrim është përpiluar në bazë të nenit 36 të po të njëjtës rregulloreje.

Komuna e Lipjanit me datën 10.08.2020 në web faqe ka nxjerrë njoftimin për kandidatin e suksesshëm, kandidati me më shumë pikë gjatë testit me shkrim dhe me gojë është Ardian Metaj me 84.7 pikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se KPSHC me rastin e përzgjedhjes së kandidatit për pozitën “Zyrtar i Gjendjes Civile 1 në zyrën e vendit Magure” në Komunën e Lipjanit, Ardian Metaj si kandidati i cili ka grumbulluar me se shumti pikë, ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”*. Kandidati i përzgjedhur z.Ardian Metaj posedon Diplomën e datës

06.09.2017 me nr.1223/17 e lëshuar nga kolegji AAB në Prishtinë dhe mori titullin bachelor në Administratë Publike, dhe ka këtë përvojë pune: prej datës 01.04.2017 deri më datën 28.02.2020 sipas vërtetimit të datës 01.07.2020 në pozitën menaxher në biznesin “Milaim Metaj” B.I Magure.

Kolegji mori parasysh faktin e parashtrimit të ankesës drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke vlerësuar si fakt jo relevant në vendosje meritore të kësaj lënde.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të të gjitha provave të lëndës ka konstatuar që Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Komunës së Lipjanit, procedurën e rekrutimit për pozitën “Zyrtar i Gjendjes Civile 1 në zyrën e vendit Magure” e ka zhvilluar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1, se: **11.1”Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve.** Andaj Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se KPSHC ka vepruar në pajtim me dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Vendimi për ndryshimin e një anëtarit të Komisionit Përzgjedhës të shërbimit civil i datës 04.08.2020 Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit ██████████
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr.265/2020;

Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit



Sabile AVDYLI
Procesmbajtëse

